



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 239, Datë 23.12.2019

MBI

**RISHIKIMIN E VENDIMIT NR. 114, DATË 22.07.2019, MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“S.P.E GJADËR” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA HEC “GJADËR NR. 1/1” ME KAPACITET TË INSTALUAR 2134 KW,
HEC “GJADËR NR. 1/2” ME KAPACITET TË INSTALUAR 4406 KW, HEC “GJADËR NR.
2” ME KAPACITET TË INSTALUAR 2983 KW, HEC “GJADËR NR. 3”, ME KAPACITET
TË INSTALUAR 3874 KW, HEC “GJADËR NR. 4” ME KAPACITET TË INSTALUAR 5922
KW, HEC “GJADËR NR. 5” ME KAPACITET TË INSTALUAR 5619 KW, ME KAPACITET
TOTAL TË INSTALUAR 24938 KW.**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2 gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, si dhe nenit 16 pika 1 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 23.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 12/1 Prot, datë 20.12.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, lidhur me rishikimin e vendimit Nr. 114, datë 22.07.2019, Mbi licencimin e shoqërisë “S.P.E Gjadër” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

Konstatohet se:

- ERE me vendimin nr. 114, datë 22.07.2019, vendosi:
 1. Të licencojë shoqërinë “S.P.E Gjadër” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga: “HEC Gjadër Nr.1/1” me kapacitet të instaluar 2134 kW, “HEC Gjadër Nr. 1/2” me kapacitet të instaluar 4406 kW, “HEC Gjadër Nr. 2” me kapacitet të instaluar 2983 kW, “HEC Gjadër Nr. 3” me kapacitet të instaluar 3874 kW, “HEC Gjadër Nr. 4” me kapacitet të instaluar 5922 kW, “HEC Gjadër Nr. 5” me kapacitet të instaluar 5619 kW; me kapacitet të instaluar total 24938 kW, për një afat 29 vjet e 2 muaj, me kushtin që brenda 3 muajve të dokumentojë marrjen e lejes së ndërtimit të zbardhur.
 2. Në çdo rast që Autoriteti Kontraktor do të shprehet me vendim për shtyrje të afatit të ndërtimit dhe vënies në punë të veprës, shoqëria “S.P.E Gjadër” sh.p.k. t’i drejtohet ERE-s për miratimin e ndryshimeve që do të prodhojë kontrata shtesë e konçesionit.
- Duke qënë se nga ana e shoqërisë ky kusht nuk u plotësua në kohë, në përfundim të afatit të kushtit të dispozitivit të sipërcituar, ERE i’u drejtua shoqërisë “S.P.E Gjadër” sh.p.k., me shkresën nr. 195/4 Prot, datë 19.11.2019, duke i kërkuar informacion mbi plotësimin e tij.

- Në përgjigje të shkresës së ERE, shoqëria “S.P.E Gjadër” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 195/10 Prot, datë 10.12.2019, ka përcjellë shkresën drejtuar MIE me nr. 338 Prot, datë 10.12.2019, me anë të së cilës i ka shprehur shqetësimin në lidhje me mospërkrahjen nga kjo e fundit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues për të garantuar zbardhjen e Lejes së ndërtimit të lëshuar me vendimin e KKT me nr. 9, datë 09.09.2015.
- ERE vlerësoi se plotësimi i kushtit të vendimit të ERE-s Nr. 114, datë 22.07.2019, nuk varet nga vullneti i shoqërisë së licencuar por nga ai i institucioneve shtetërore. ERE mori në konsideratë përpjekjet që shoqëria ka bërë për të plotësuar këtë kusht që nga fillimet e aplikimit për licencë.
- Shtyrja e afatit të ndërtimit dhe vënies në punë të veprës, për shkak të mos marrjes së lejes së ndërtimit, kërkon ndryshime në kontratën e koncesionit që lidhen me afatet e përcaktuara në të për përfundimin e ndërtimit dhe vënies në punë të veprës.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të ndryshojë pikën 1 të vendimit të ERE nr. 114, datë 22.07.2019, si vijon:
Të licencojë shoqërinë “S.P.E Gjadër” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga: “HEC Gjadër Nr.1/1” me kapacitet të instaluar 2134 kW, “HEC Gjadër Nr. 1/2” me kapacitet të instaluar 4406 kW, “HEC Gjadër Nr. 2” me kapacitet të instaluar 2983 kW, “Hec Gjadër Nr. 3” me kapacitet të instaluar 3874 kW, “HEC Gjadër Nr. 4” me kapacitet të instaluar 5922 kW, “HEC Gjadër nr. 5” me kapacitet të instaluar 5619 kW; me kapacitet të instaluar total 24938 kW, për një afat 29 vjet e 2 muaj, me kushtin që përpara vënies në operim të veprës të depozitohet në ERE kontratën shtesë të koncesionit.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë shoqërinë “S.P.E Gjadër” sh.p.k dhe Ministrinë e Infrastrukurës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI